

NJOFTIM

“Njoftim për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Kurbin”

Njoftim për aplikime për të përfituar nga programi social i strehimit “Banesa me qira” si instrument financiar “Bonus Qiraje” që zbaton Bashkia Kurbin

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM -së nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar, VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

Njoftojmë të gjithë qytetarët e interesuar të Bashkisë Kurbin për t’u trajtuar me strehim, fillojnë aplikimet për të përfituar nga programi me Banesat sociale si instrument financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë”.

Aplikimet do të kryhen online në portalin qeveritar E-Albania dhe do të jenë të hapura deri me datë 10.11.2026.

Bashkia Kurbin zbaton programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” me instrumentin financiare (subvencionimin e qirase), që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Aktualisht, po kërkojme të zbatojme programet sociale të strehimit:

Programi i Banesave Sociale me Qira

- “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë”, si një instrument financiar në zbatim të programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”;

Kushtet, procedurat dhe dokumentacioni për të përfituar nga programet sociale të strehimit janë:

Në zbatim të VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, përcaktohen kriteret dhe procedurat për të përfituar strehim sipas çdo program, VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

Kushtet që duhen plotësuar për të përfituar nga instrumenti financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” janë: (n.13 L.22/2018 i ndryshuar)

Të jetë banor i Bashkisë Kurbin;

Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;

Të mos ketë/disponojë banesë në pronësi ose të zotërojë një sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, sipas përcaktimeve ligjore ose ka mbetur i pastrehë për shkak të përcaktuara në ligj;

Ka të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar qiranë në tregun e lirë për një strehim të përshtatshëm dhe norma të strehimit të përcaktuar në ligj.

Procedurat për të përfituar nga programet sociale të strehimit janë:

Faza e parë:

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga ky program, sipas ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës on-line në portalin unik qeveritar “e-Albania”.

Faza e dytë:

Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata individë/familje që plotësojnë kushtet për t’u trajtuar me këtë program.

Dokumentacioni i nevojshëm është sipas VKM-së nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Struktura përgjegjëse për strehimin në bashki klasifikon kërkesat sipas sistemit të pikëzimit, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak dhe realizon shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga çdo aplikues, si dhe në vijim **dërgon për vlerësim dhe shqyrtim të mëtejshëm pranë Komisionit të Strehimit.**

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit lista e kerkuesve dhe dokumentacioni perkates vleresohen nga Komisioni i Strehimit, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki dërgon për miratim në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, listën e perfituesve për secilin program social të strehimit që zbaton.

Çdo aplikues që nuk ka përmbushur kriteret për të qenë pjesë e listës përfituese, njoftohet nga struktura përgjegjëse për strehimin në bashki dhe mund të paraqesë ankim pranë Kryetarit të Bashkisë dhe Gjykatës kompetente.

**Lista e dokumentacionit të nevojshëm është:
(vkm 384 dt.12.06.2019)**

Për të dhënat personale:

- Certifikata e lindjes së aplikantit/ certifikatë personale/(gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania); kopje kartë identiteti;
- Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetqeverisjes vendore, ku kërkohet strehim social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

Për vërtetimin e kushteve të banimit:

- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për pronat që disponohen ose jo në emër të secilit anëtar të familjes (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- Vërtetim nese ka ose jo banesë ne proces legalizimi (e-Albania);
- Akt-verifikimi nga Bashkia për:
- Banesat në rrezik shembjeje;
- Rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
- Banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit;
- Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- Akt-verifikimi nga njësia vendore strehimit për familjet e minoritet kombëtar Rom dhe Egjiptian, që banojnë në banesa individuale ose struktura, që nuk klasifikohen si banesë.

Për vërtetimin e kushteve familjare:

- Çertifikatë familjare (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vendim i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

Për vërtetimin e kushteve sociale:

- Vërtetim i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP), për individë me aftësi ndryshe,
- Vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- Dokument që vërteton që ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuar;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve;
- Vërtetim nga Policia e Shtetit;

- Vërtetim nga Garda e Republikës;
- Vërtetim nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm;
- Vërtetim nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Vërtetim nga Forcat e Armatosura;
- Urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, lëshuar nga gjykata;
- Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Shërbimit të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje;
- Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.
- Vetëdeklarim nëse individ/familja i përket minoritetit kombëtar Rom apo Egjiptian;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për familjet e minoritetit kombëtar Rom;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBT-I;
- Dokument zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- Vërtetim me certifikatë familjare se individ i përket kategorisë vajzë- nënë

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

- Vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre , të cilave duhet ti bashkëlidhen dokumente zyrtare që e vërtetojnë atë , përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikuesit e të personave të tjerë madhorë të familjes që janë në marrëdhënie pune (vërtetim page për 3 muajt e fundit (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania).
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e Instituti i Sigurimeve Shoqërore për derdhjen e kontributeve për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Zyra e Ndhmës Ekonomike të bashkisë për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (sigurohet nga Bashkia, e-Albania);
- Vërtetim për të ardhurat vjetore të biznesit për personat e vetëpunësuar / Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimor
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania),
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për personat në pension (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania).

Në rastin e aplikimit për instrumentin financiar të subvencionimit të qirasë , duhet të jetë lidhur kontratë qiraje përpara noterit ndërmjet aplikuesit në cilësinë e qiramarrësit dhe pronarit në cilësinë e qiradhënësit ku të jetë përcaktuar : Afati i kontratës, struktura e banesës, shuma qirasë.